



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCES - VERBAL

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 5 shkurt 2018, ora 10:15, pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), përfaqësues nga AMSHC dhe ekspertë të Asistencës Teknike.

Në takim marrin pjesë:

Anëtarë të shoqërisë civile të KKSHC-së:

1. Z. Blendi Dibra
2. Znj. Arta Dyrmishi
3. Z. Ergys Gezka
4. Znj. Emanuela Zaimi
5. Z. Ali Coka
6. Z. Luan Ahmetaj
7. Znj. Artemisi Shehu
8. Z. Vladimir Thanó

Përfaqësues nga AMSHC:

1. Znj. Ina Gjini
2. Z. Andi Luga
3. Znj. Leonida Hasa

Ekipi i Asistencës Teknike:

1. Znj. Christine Leiser
2. Z. Max Fras

10:15 – Znj. Christine mbajti fjalën e hapjes duke u prezantuar veten, ekipin dhe objektivat për anëtarët që nuk kanë qenë në trajnimet e shkuara. Ajo theksoi se misioni kryesor për këtë muaj është rishikimi i Udhërrëfyesit, duke qenë se BE kërkon rishikimin e tij në fund të këtij muaji. Znj. Christine njofton të pranishmit se së bashku me z. Blendi do të largohen rreth orës 11:00 për arsye të një takimi në Ministri.

Ajo prezanton ekspertin për zhvillimin e kapaciteteve, z. Max, i cili kërkon që gjatë mbledhjes të fokusohen te katër pikat e para të Kalendarit të Aktiviteteve 2018. Gjithashtu ai shtoi se edhe pse ky është një plan pune 1-vjeçar, do ishte mirë që ky plan të jetë i parashikuar për të qenë më afatgjatë, 3-vjeçar.

Z. Max falënderon znj. Ina përfaqësuese nga AMSHC për mbajtjen e proces-verbalit dhe shton se një nga pikat e diskutimit do të jetë për buxhetin e përcaktuar nga AMSHC-ja për mbështetjen që do t'i ofrojë Këshillit.

Ai sqaron se si pikë të fundit, por të rëndësishme do të diskutohet për ngritjen e kapaciteteve për të cilat është diskutuar edhe në mbledhjet e mëparshme dhe se i ka organizuar në disa pika përmbledhëse. “Nëse do të ketë kohë do të shohim edhe pikën e fundit të aktiviteteve”, - përfundoi ai.

Z. Blendi bëri një prezantim të shkurtër të Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2018. Ai shtoi, se lidhur me pikën e parë për mbledhjet periodike të KKSHC-së duhet përcaktuar nga ana indikative sa herë do mblidhen, që të parashikohet edhe në buxhet.

Anëtarët dolën në përfundimin se 1 (një) herë në muaj është e mjaftueshme të takohen, mjafton të jenë edhe dy veta, por ta ndajnë informacionin edhe me të tjerët.

Gjithashtu, lidhur me pikën e parë, anëtarët diskutuan dhe ranë dakord që mbledhjet e KKSHC-së të mbahen në vende neutrale, siç është AMSHC-ja ose EU Info Center dhe jo pranë zyrave të organizatave partnere.

Përsa i përket pikës së dytë të diskutimit “Propozimet mbi hartimin e ligjeve apo ndryshimet ligjore” disa nga anëtarët e KKSHC-së shprehen se nuk janë ekspertë ligjorë dhe nuk mund të draftojnë ligje.

Gjithashtu u diskutua për çështjen e regjistrimit të shoqatave në gjykatë dhe amendimeve të ndryshme për të cilat mund të bëhet një V.K.M.¹ dhe të ndryshohet ashtu siç u bë për bizneset, të cilat regjistrohen në QKR.

¹ Vendim i Këshillit të Ministrave

10:52 - Z. Max thotë se deri më datë 16 shkurt 2018 eksperti ligjor i BE-së do të jetë në Tiranë dhe mund të japë sugjerime. Gjithashtu, për çështjen e regjistrimit, ai shton se edhe në Udhërrëfyes thuhet se regjistrimi duhet decentralizuar.

10:55 – Znj. Christine i kujton z. Vladimir takimin që do të zhvillojnë më datë 6 shkurt 2018 me ekspertin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertit ligjor të BE-së, ku mund të diskutojnë për propozimin dhe ndryshimet në ligje.

Disa nga anëtarët propozuan shtimin në pikën dy të draft-ligjit për sponsorizimet dhe ndërmarrjet sociale. Z. Luan dhe z. Ali shprehen se mund të shtohet edhe draft-ligji për përmirësimin e manualit të shërbimeve mjedisore.

11:00 – Znj. Christine ndërhyr duke sugjeruar se duhet sqaruar mandati i Këshillit, për të mos u kthyer mbrapsht. “Është e rëndësishme që këto dy muaj të fokusohemi e të punojmë me Ministrinë, në mënyrë që ato të marrin në shqyrtim çështjet që ne do t’i propozojmë”, - thotë ajo.

Gjithashtu ajo shtoi: “Roli kryesor i KKSHC-së është të ushtrojë presion për rregullimin e ligjeve bazë të funksionimit të shoqërisë civile, siç janë: regjistrimi; shpërndarja e fondeve; taksimi etj. (legjislacion që do të jetë në fuqi për vite me rradhë). Pastaj mund të merremi me ligjet e tjera gjithpërfshirëse të shoqërisë civile, siç janë: çështjet sociale; mjedisi; integrimi në BE etj.. Duhet fuqizuar rrjeti (network) i shoqatave, për të terhequr pranë vetes ato shoqata që kanë iniciativa të mira ligjore - këto rrjete do të shfrytëzohen edhe në të ardhmen për të arritur te Qeveria.”

Znj. Christine shprehet se KKSHC nuk duhet të draftojë ligje, por duhet të dijë se cila organizatë i bën ato.

Në vijim, z. Max thotë se do të ndryshojmë mënyrën si është shprehur kjo gjë në Kalendar. Përsa i përket monitorimit të Udhërrëfyesit, takimet me përfaqësues të Kryeministrisë dhe institucioneve publike po realizohen dhe është e rëndësishme të krijohet vazhdimësi.

11:20 - Z. Blendi shtron idenë se lidhur me organizimin e “Konferencës së Parë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile” (Aktiviteti 4, sipas Kalendarit) është shumë e rëndësishme për të ftuar të gjithë organizatat të prezantojnë propozimet e tyre. Ai shton se ka organizata që kanë bërë punë shumë të bukura dhe do të ishte mirë t’i njohim të gjithë dhe të ndërtojmë një “*Follow up*” nga këto eksperiencat.

Gjithashtu disa nga anëtarët e tjerë propozuan se do të ishte më mirë që të zhvillohet fillimisht “Organizimi i tre takimeve rajonale konsultuese me OJF-të” (Aktiviteti 5, sipas Kalendarit) dhe pastaj të mbahet Konferenca Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.

Më pas z. Blendi dhe znj. Christine largohen, gjithashtu edhe znj. Emanuela.

Në vijim, z. Max merr fjalën dhe thotë se për organizimin e Konferencës ka buxhet. Gjithashtu ai u shpreh se Kryetarja e KKSHC-së, znj. Ogerta Manastirliu ia ka deleguar disa funksione një Drejtorie në Ministri dhe u sqaroi anatarëve të cilët e kundërshtuan këtë fakt, duke u thënë se ky nuk është vendim formal, por zgjidhje praktike, duke qenë se ministrja ka një axhendë të ngjeshur dhe nuk mund të marrë pjesë në çdo takim. Z. Max shton se me ligj Kryetares i takon vetëm të kryesojë mbledhjet.

Përsa i përket buxhetit, z. Max shprehet se AMSHC konfirmon se janë 6 (gjashtë) milion lekë në dispozicion të Këshillit për aktivitete që parashikon ligji.

Ai shton se ky buxhet duhet përdorur në bazë të planit të punës dhe se buxheti përfundimtar do të vendoset në muajin Prill 2018, kështu që ka ende kohë për ta rishikuar. Të parashikohet, sa do të shpenzohen për Konferencën dhe sa do jenë përmasat e saj.

Z. Vladimir shprehet se është mirë të menaxhohen të ardhurat në mikro pastaj në makro. Me këtë buxhet është e rëndësishme të bëhen takime të vogla dhe propozime reale dhe të draftohet buxheti për grupet e vogla të punës.

Z. Max sqaron se kategoritë e lejueshme të shpenzimeve janë: qera salle, kafe, rimbursim udhëtimi, akomodim, publikime, ekspertizë, etj..

12:05 – Z. Fras, duke iu referuar Planit të Ngritjes së Kapaciteteve, shprehet se lidhur me “Kapacitetin institucional” është bërë progres pasi është miratuar Rregullorja e KKSHC-së, është zgjedhur ZëvendësKryetari i Këshillit.

Lidhur me “Kapacitetin financiar” deri tani është përcaktuar një buxhet me vlerë 600,000 lekë për shpenzimet e Këshillit, megjithëse jo i mjaftueshëm.

Në vijim, z. Fras fton anëtarët e shoqërisë civile të KKSHC-së, që si hap të parë, të kontaktojnë me z. Dibra dhe t’i dërgojnë sugjerimet mbi takimet që parashikojnë të zhvillojnë, “Ku?”, “Me kë?”, “Çfarë qëllimi?” etj.

Gjithashtu, ai u sugjeron që lidhur me rritjen e buxhetit, të bëhet në mënyrë të strukturuar, nga plani i detajuar si dhe të fokusohen në prioritetet e Udhërrëfyesit.

Nga diskutimi për buxhetin që AMSHC do të verë në dispozicion për KKSHC-në, lindën disa pyetje nga anëtarët e pranishëm, të cilave iu përgjigj znj. Leonida Hasa, “Përgjegjëse e Sektorit - Monitorimi Financiar i Granteve”, pasi u thirr të merrte pjesë në diskutim.

Dy pyetjet kryesore që u shtruan ishin:

1. Sa përqind është buxheti i parashikuar për KKSHC-në në raport me fondin e përgjithshëm të AMSHC-së?
2. Sa është fondi vjetor i AMSHC-së?

Znj. Leonida u sqaron se fondi i përgjithshëm vjetor i AMSHC-së është 122 milion lekë, nga të cilat 50 milion janë për të mbuluar këto lloj aktivitetesh. Ajo shton se AMSHC është bashkëpunuese dhe se ka raste që mund të kërkohen fonde shtesë nëpërmjet P.B.A.²-së ose të bëhen trasfertë nga një llogari në tjetrën. Ajo shton se është e rëndësishme, që AMSHC të jetë në dijeni të aktiviteteve, sepse në bazë të tyre bëhet planifikimi buxhetor. Më tej shprehet se pjesa e buxhetit mund të bëhet me V.K.M., aktualisht kemi vetëm nenin 15 të ligjit për KKSHC-në, ku saktësohet se shpenzimet, në lidhje me veprimtarinë e KKSHC-së, mbulohen nga AMSHC-ja, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Z. Vladimir pyet nëse duhet ta propozojmë hartimin e V.K.M.-së në mbledhjen Kombëtarë.

Znj. Leonida i pergjigjet se duhet lobuar për V.K.M.-në, sepse është në ndihmë edhe të AMSHC-së edhe të KKSHC-së.

Z. Max shton se lista e shërbime që AMSHC mund të bëjë për Këshillin, është mirë që t'i dërgohet të gjithë pjestarëve të KKSHC-së së bashku me proces-verbalin dhe tabelën për prezantimin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërtuar nga ai vetë.

Z. Luan pyet nëse parashikohen buxhete për të shkuar jashtë vendit.

Znj. Leonida i pergjigjet se veprimtaria e kryer jashtë shtetit, në radhë të parë duhet të jetë e lidhur me KKSHC-në dhe duhet të marrë miratim nga Këshilli i Ministrave dhe nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

12:36 – Në mbyllje të takimit, anëtarët e pranishëm ranë dakord që takimi i radhës të zhvillohet më datë 20 shkurt 2018, ora 10:00, pranë ambjenteve të AMSHC-së.

SHTOJCA 1:

DRAFT - KALENDARI I AKTIVITETEVE 2018

² Programi Buxhetor Afatmesëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

KALENDARI I AKTIVITETEVE 2018

Aktiviteti 1: Mbledhjet periodike të KKSHC

Sipas sektorëve të përcaktuar nga Ligji / sipas çështjeve

Vendi: Pranë ambienteve të AMSHC-së, ora 08:00 -16:30

Aktiviteti 2: Propozimet mbi hartimin e ligjeve apo ndryshimet ligjore:

2.1 Draft-ligji për financimin e OSHC-ve në nivel qendror dhe vendor

- a) *Organizimi i takimeve me përfaqësues të BE*
- b) *Konsultime me përfaqësues të Institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal*
- c) *Konsultime me përfaqësues të OJF-ve.*

2.2. Draft-ligji/Amendamente për probleme të taksimit të OJF-ve/TVSH

- a) *Organizimi i takimeve me përfaqësues të Ministrisë së Financave*

2.3. Amendime të ligjit për regjistrimin e OJF-ve

- a) *Hartimi i propozimeve për amendimin e ligjit*

Aktiviteti 3: Monitorimi i zbatimit të Udhërrëfyesit/Roadmap

Takime me përfaqësues të Kryeministrisë dhe institucioneve publike për të grumbulluar informacionin zyrtar në lidhje me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhërrëfyes sipas afateve përkatëse

Aktiviteti 4: Organizimi i tre takimeve rajonale konsultuese me OJF-të:

- *Progres zbatimi i Roadmap*
- *Prezantimi i planit strategjik për KKSHC*
- *Prezantimi i iniciativave ligjore të KKSHC të përgatitura nga aktiviteti 2 dhe grupet e punës sektoriale*

Data: Prill – Qershor 2018

Aktiviteti 5: Organizimi i **Konferencës së Parë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile:**

- *prezantimi i progresit në lidhje me çështjet e trajtuara në grupe pune nëpërmjet aktiviteteve 1, 2, 3.*
- *Përcaktimi i prioritetëve dhe hartimi i planit strategjik*

Vendi: Tiranë

Pjesëmarrës: Përfaqësues të institucioneve publike dhe parlamentit, donatorë potencial, organizata ndërkombëtare, përfaqësi diplomatike, përfaqësues të OJF-ve etj

Data: Shtator - Tetor 2018

Aktiviteti 6: Organizimi i Mbledhjeve Zyrtare të KKSHC-së për vitin 2018

6.1 Mbledhja e parë zyrtare: Mars 2018

- *Miratimi i kalendarit të aktiviteteve të KKSHC*
- *Miratimi i raportit vjetor (i cili do përgatitet me asistencën e ekspertëve të BE-së)*
- *Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës me përfaqesuesit e institucioneve publike në funksion të realizimit të aktivitetit 2 dhe 3*
- *Miratimi i organizimit të Konferencës Kombëtare të Shoqërisë Civile*

6.2. Mbledhja e dytë zyrtare e KKSHC: *Korrik 2018*

6.3. Mbledhja e tretë zyrtare e KKSHC: *Nëntor 2018*